



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E FINANCE BUXHET DHE KONTABILITET

Nr. 12170 prot

Fier, më 30.10.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 96. datë 30.10 2025.

“Për një ndryshim (shtesë fondesh) në VKB nr. 139, datë 23.12.2024, ‘Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025’, i ndryshuar, nga Transferta e pakushtëzuar sektoriale , për të rritur cilësinë e shërbimit të sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”

Mbeshtetur ne ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Per Veteqverisjen Vendore” i ndryshuar; nenet 34,40,41,54 dhe 55, Ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor nd RSH” te ndryshuar, Kreu III nenet 10-20, kreu IV, nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 te ligjit nr.68 dt.27.04.2017 “Per Financat e Vetqeverisjes Vendore”, Ligjin nr. 10296 date 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiare dhe Kontrollin”, Vendimit te Keshillit te Bashkisesnr. 139, datë 23.12.2024, ‘Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025’, i ndryshuar Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018 të Ministrisë se Financave “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, te ndryshuar , Akti normative nr. 10 dt 08.10.2025 , botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 194 date 21.10.2025 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr 115 /2025 “Per buxhetin e Vitit 2025” te ndryshuar, si dhe shkreses se Ministrise se Financave nr.14505/11prot., date 24.10.2025 ,protokolluar prane Bashkise Fier me nr.11993 prot.,date 27.10.2025 , ekzekutivi i Bashkise Fier

PROPOZON:

1. Buxheti i Bashkisë Fier të shtohet nga trasferta e pakushtëzuar sektoriale me vlerën **4,929,000 (katër milion e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë dhe Buxheti i Bashkisë nga 3,431,770,971(tre miliard e katërqind e tridhjetë e një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) lekë do të shkoj në 3,436,699,971(tre miliard e katërqind e tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) lekë.**

Entiteti I qeverisjes	Ministria e Linjes	Kod institucioni	Emertimi I Institucionit	Kap	Prog.	Llog. Ekon.	Kod Thesarit	Kod I projektit	Emertimi I produktit	Shuma
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	03280	6040000	0909	90001AA	Shpërblim për punonjësit e angazhuar në shuarjen e zjarreve	4,929,000
Shuma										4,929,000

2-Të shpërndahet trasferta e pakushtëzuar sektoriale si më poshtë :

➤ **Aparati i Bashkisë Fier**

- 2111001, kap 01, program 03280, artikull 602 , kod projekti 9999999, Shpenzime për të rritur cilësinë e shërbimit të sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Entiteti i qeverisjes	Ministria e Linjës	Kod institucioni	Emërtimi i Institucionit	Kap	Prog.	Llog. Ekon.	Kod Thesarit	Kod i projektit	Emërtimi i produktit	Shuma
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	03280	6029999	0909	90001AA	Shpenzimeve operative për rritjen e cilësisë së sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	4,929,000
Shuma										4,929,000


3. Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtoria e Shërbimit MZSH, të Bashkisë Fier.

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit

Pranvera Çina

**Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj**

**KRYETARI
Armando Subashi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER
DREJTORIA E FINANCË BUXHET DHE KONTABILITET

Nr. 12170 / prot
1

Fier, më 30.10 .2025

RELACION

Lënda: Për një ndryshim (shtesë fondesh) në VKB nr. 139, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025', i ndryshuar, nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale , për të rritur cilësinë e shërbimit të sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Fier

Të nderuar këshilltarë,

Ky relacion është paraqitur para jush në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Per Veteqverisjen Vendore" i ndryshuar; nenet 34,40,41,54 dhe 55;
- Ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH" të ndryshuar, Kreu III nenet 10-20, kreu IV, nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40;
- Ligjit nr.68 dt.27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore";
- Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiare dhe Kontrollin";
- VKB nr. 139, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025', i ndryshuar;
- Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.483, datë 02.09.2025 "Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025 "
- Aktin normative nr. 10 dt 08.10.2025, botuar në Fletorën Zyrtare nr. 194 datë 21.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 115/2024 "Për buxhetin e Vitit 2025" të ndryshuar.
- Si dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.14505/11prot., datë 24.10.2025 ,protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.11993 prot.,datë 27.10.2025 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025.

Më datë 08 Tetor 2025 Këshilli i Ministrave ka miratuar Aktin Normativ nr.10 datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar. Ky akt normative është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 194 datë 21.10.2025.

Sipas aktit normative nr.10 ,Bashkisë Fier i është akrodruar një fond nga transfertat e sektoriale , në vlerë 4,929,000 lekë, për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve.

Në zbatim pikës 3 , të Vendimit të Këshillit të Ministave nr.483, datë 02.09.2025 "Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025 " , protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr. 10060 prot., datë 08.09.2025 , ka dalë urdhëri i titullarit nr.400 me numër 10280 prot., datë 12.09.2025 **"Për dhënie shpërblimi personelit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025"**, ku është urdhëruar kryerja e pagesës duke u bazuar në kohëzgjatjen e angazhimit të personelit.

Në pikën 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministave nr.483, datë 02.09.2025 "Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025 " citohet:

1. *Dhënie shpërblimi personelit, punonjës shtetërorë, të angazhuar në shuarjen e zjarreve gjatë verës së vitit 2025.*
2. *Shpërblehen punonjësit e:*
 - a) *Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;*
 - b) *Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;*
 - c) *Policisë së Shtetit;*
 - c) *Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;*
 - d) *Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në bashki.*

Dhe në pikën 9 të VKM-së nr.483 ,datë 02.09.2025, përcaktohet se: *Efekti financiar për strukturat e përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga buxhetet përkatëse të njësisë të vetëqeverisjes vendore.*

Bazuar në pikën 1,2,3 dhe 9 të VKM –së është bërë pagesa me urdhër shpenzim nr. 743 datë 12.09.2025 në vlerën bruto 7,659, 200 lekë (përfshirë edhe tatimin në burim) , bazuar në kohëzgjatjen e angazhimit të personelit, sipas listëprezencës dhe listëpagesës për orët suplementare të punonjësve të MZSH-së për periudhën Qershor-Korrik-Gusht 2025.

Listëprezencat dhe listëpagesa me përlogaritjen e shpërblimit për çdo punonjës të angazhuar në shuarjen e zjarreve për periudhën Qershor- Gusht,janë dorëzuar të firmosura nga Drejtoria e Shërbimit MZSH të Bashkisë Fier.

Fondet për shpenzimet e mësipërme janë përballuar nga artikulli 606 i buxhetit të Aparatit të Bashkisë Fier, miratuar për vitin 2025.

Mbështetur në shkresën e Ministrisë së Financave nr.14505/1 lprot., datë 24.10.2025 , protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.11993 prot.,datë 27.10.2025 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025, cilësohet se :**Bashkitë të cilat kanë akorduar shpërblimin e punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi nga buxheti i tyre do ta përdorin këtë fond për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.**

3. Për sa më sipër ,ekzekutivi I Bashkisë Fier , propozon që buxheti i Bashkisë Fier të shtohet nga trasferta e pakushtëzuar sektoriale me vlerën **4,929,000 (katër milion e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë dhe Buxheti i Bashkisë Fier shkon nga 3,431,770,971**(tre miliard e katërqind e tridhjetë e një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) **lekë do të shkoj në 3,436,699,971**(tre miliard e katërqind e tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) **lekë.**

Entiteti I qeverisjes	Ministria e Linjes	Kod institucioni	Emertimi I Institucionit	Kap	Prog.	Llog. Ekon.	Kod Thesarit	Kod I projektit	Emertimi I produktit	Shuma
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	03280	6040000	0909	90001AA	Shpërblim për punonjësit e angazhuar në shuarjen e zjarreve	4,929,000
Shuma										4,929,000

Transferta e pakushtëzuar sektoriale të shpërndahet si më poshtë :

➤ Aparati I Bashkisë Fier

2111001, kap 01, program 3280, artikull 602 , kod projekti 9999999, Shpenzime për të rritur cilësinë e shërbimit të sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.


Entiteti I qeverisjes	Ministria e Linjës	Kod institucioni	Emërtimi I Institucionit	Kap	Prog.	Llog. Ekon.	Kod Thesarit	Kod I projektit	Emërtimi i produktit	Shuma
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	03280	6029999	0909	90001AA	Shpenzime operative për rritjen e cilësisë së sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	4,929,000
Shuma										4,929,000

Ju faleminderit!

Drejtoria e Finacës Buxhetit dhe Kontabilitetit

Nëpunës Zbatues

Pranvera Çina



KRYETARI
Armando Subashi